



KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË
SKUPŠTINA OPŠTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



PROCESVERBAL IX/2024

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 9 (nëntë) për vitin 2024 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 26.09.2024
Ora: 10.00

Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci

Z.Selman Kolgeci

Z. Flamur Bytyqi

Z. Urim Suka

Z. Kushtrim Kuçi

Znj. Elmaze Bytyqi

Znj. Bulëza Kuçi

Znj.Doruntina Zenelaj

Z.Alban Berisha

z.Xhevxhet Gashi

Z. Bexhet Kuçi

Z. Reshat Selimaj

Z. Lirim Qatani

Z. Aziz Bytyqi

Znj.Sanie Kuçi-

Rexhepaj

Znj.Fidaije Kukaj

Znj. Afërdita Morina

Z. Vullnet Luzhnica

Z.Edon Sadikaj

Znj.Saranda

Bajraktari

Znj.Mimoza Bajraktari

Znj.Festë Kabashi

Z.Dardan Berisha

Z.Bajram Basha

Znj.Mevlude Kabashi

Znj.Sheqerije Zyrapi

Znj.Laureta Tafaj

Z.Liridon Fandaj

Z.Qëndrim Elshani

Z.Herolind Limaj

Znj.Jehona Lumi-

Rrafshi

Të pranishëm të tjerë

**Kryetari Komunës
Media dhe qytetarë
OSCE, LMT, KDI
Znj.Habibe Bytyqi
Z.Xheladin Sadikaj**

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi,i cili propozoi këtë:

REND DITE

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e të hyrave e të dalurave të buxhetit të Komunës së Suharekës për vitin 2025;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për lirim nga taksa në aktivitet;**
- 5. Pyetje dhe përgjigje;**

Kryesuesi - thotë që është një kërkesë nga Kryetari dhe ia jep fjalën Kryetarit.

Kryetari - për shkak që e kemi përvjetorin e Ukë Bytyçit në muajin tetor dhe seanca ka m'u mbajtur në fund të muajit,unë e kam dhënë një propozim që ish Kryetarit të Komunës z.Sali Asllanaj t'ia ndajmë çmimin "Ukë Bytyçi".Komisioni e ka pas takimin dhe unë kërkoj të futet si pikë shtesë në rend dite.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën shtesë.

22 për, Miratohet pika shtesë

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës me pikën shtesë.

Unanimisht Miratohet

Pika 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - pyet nëse dikush ka vërejtje.

Selman Kolgeci - nuk është pasqyru një debat që kemi pas me Kryetarin Muharremaj te pika e pyetjeve. Secili debat që pasqyrohet këtu është mirë me u pasqyru në procesverbal.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën1 me vërejtjen që u dha.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e të hyrave e të dalurave të buxhetit të Komunës së Suharekës për vitin 2025;

Kryesuesi - e elaboron pikën 2 dhe hap debatin.

Urim Suka - përshëndet të pranishmit.Projektvendimi për kornizën afatmesme buxhetore 2025-2027 si një nga dokumentet më të rëndësishme që ky kuvend merr,meriton trajtimin maksimal të secilit prej nesh me të vetmin qëllim që ti ofrojmë qytetarëve një buxhet që adreson kërkesat e tyre.Kur jemi te projekt-vendimi që ju keni sjell,më lejoni të theksoj që ky dokument nëse karahasohet me dokumentet që ju keni sjell vitet paraprake është pak më i kompletuar edhe pse në përmbajtje ka plot lëshime të cilat do ti adresojmë në vazhdim.Unë në përpjekjen që ti ofrojmë qytetarëve një planifikim të buxhetit sa më të mirë i jam përgjigjur pozitivisht ftesës nga Kryesuesi në bashkëpunim me OSBE-në për një takim pune lidhur me hartimin e këtij dokumenti ku edhe kam adresuar disa nga vërejtjet për buxhetin.Ajo që dua të theksoj është fakti që shumica e vërejtjeve që kam adresuar në këtë takim,ju i keni marrë parasysh dhe e vlerësoj.

Përkundër gjithë kësaj unë vazhdoj të mendoj që ky buxhet ka ende nevojë për përmirësim me qëllim që të kemi një buxhet që mbron interesat qytetare dhe lidhur me këtë sot do ti adresoj disa nga shqetësimet që unë kam hasur gjatë analizës që unë i kam bërë këtij buxheti. Në fshatin Doberdelan në këtë projekt-buxhet për vitin 2025 janë planifikuar rrugët “Izet Shefqeti dhe Bajram Islami” por këto dy rrugë figurojnë edhe në planifikim për vitin 2024 dhe unë nuk e kam të qartë se këto rrugë a do të shtrohen në vitin 2024 apo në vitin 2025 siç prap po planifikoni me këtë projekt-buxhet. Në fshatin Greiqec keni planifikuar rrugën “Bashkimi” për të cilën kam folur edhe më herët dhe të cilën e mbështes. Edhe rrugën “Esat Qarri” për të cilën rrugë vite më herët ju edhe keni pasur një kontratë dhe rruga nuk është shru për shqetësimi im është për fatin e rrugës “Dy Martirët” e cila është në planifikim të këtij viti dhe me sa unë e di ende nuk është shru dhe rruga “Seferi” me sa e di ende nuk ka përfunduar. Mirë që po planifikoni rrugën “Bashkimi dhe Esat Qarri” por çka do të bëhet me rrugën “Dy Martirët”, me pjesën e mbetur të rrugës “Seferi”? Çka do të bëhet me rrugët “Hajriz Xhema dhe 8 Vëllezërit” të cilat kanë qenë të kontraktuara vite më parë dhe nuk janë shtru? Në fshatin Luzhnicë ju keni planifikuar rrugën “Afrim Buqa” për vitin 2025 por sipas informatave që unë kam, kjo rrugë është e përfunduar dhe nuk ka segment tjetër. Pse duhet të figuroj prap kjo rrugë në buxhetin e vitit 2025? Në fshatin Vërshec ju keni planifikuar ndërtimin e rrugës “Ushtari i Lirisë”, kjo rrugë është planifikuar për disa vite me radhë. Gjatë vitit 2023 ju keni filluar dy anekse në Vërshec, e keni përgadit terenin dhe rrugët nuk janë përfunduar, madje me sa e di as këtë vit nuk janë përfunduar ndërsa tani po e planifikoni prap të njëjtën rrugë për vitin 2025. A mund të më tregoni se rrugët për të cilat e keni përgadit bazën kur do të përfundojnë në Vërshec? Në këtë buxhet janë planifikuar 230.000€ për ndërtimin e varrezave të qytetit në Biraq por a e dini se çka po ndodh atje? Në Biraq ka dy vite që vetëm gërmohet e hudhet beton. Dua të di nga ju se kujt i shërben gjithë ai beton? Ajo që po ndodh atje është e çuditshme dhe e papranueshme. Në vitin 2023 janë shpenzuar rreth 200.000€ në emër të këtyre varrezave. Gjatë këtij viti është hartuar një kontratë rreth 460.000€ dhe tash me këtë planifikim janë ndarë 230.000€ por e vërteta atje është që po kalojnë 3 vite që ka filluar planifikimi për projektin e varrezave të qytetit dhe ende atje kemi gërmim e beton. Ky beton nuk i shërben kësaj hapësire sepse hapësira për varreza nuk ka nevojë për beton por si duket ky beton po i shërben interesave të ngushta të pushtetarëve. E keqja e këtij planifikimi dhe asaj që po ndodh në teren shtohet edhe për faktin që ka disa vite që kërkoj një buxhet simbolik për rregullimin e hapësirës për varrezat në Bllacë dhe nuk ka buxhet për këtë, nuk ka as në këtë planifikim që ju keni sjell. Edhe më keq nuk ka buxhet as për hapësirën e varrezave në Studenqan. Gjithëashtu problemet me varrezat janë edhe në vendbanimet tjera ndërsa ky pushtet ka vendosur të shpenzoj gjithë këto mjete për beton disa metra të larta për varrezat e qytetit në Biraq ndërsa ka edhe arsye tjera që ky buxhet nuk duhet të kaloj sot. Planifikimi për ndriçim publik e planifikimi për kanalizime është i përgjithshëm dhe nuk specifikon se ku do të punohet. Se ky buxhet në këtë formë nuk duhet të kaloj është edhe fakti që nga buxheti i Drejtorisë së Bujqësisë janë planifikuar 100.000€ për asfaltimin e rrugës në bjeshkët e Vranqit ndërsa 100.000€ tjera për ndërtimin e infrastrukturës rrugore për bujqësi. Pse është dashur që mjetet e dedikuara për bujqësi të shkojnë në asfalt e rrugë? Këto rrugë është dashur të përfundohen nga buxheti i Drejtorisë së Shërbimeve Publike. Bujqit do të dëmtohen edhe më shumë nga ky planifikim andaj si i tillë nuk duhet miratuar. Meqenëse unë vij nga Bllaca po du me adresu disa shqetësime që unë kam ngritur në vazhdimësi dhe sot nuk po i shoh që figurojnë në këtë buxhet. Pse nuk është adresu problemi i shtratit të lumit në Bllacë? Pse nuk ka buxhet për impiantin e ujërave të zeza në Bllacë? Pse nuk ka buxhet për rregullimin e rrethojave të urës në Bllacë? Pse nuk ka buxhet për funksionalizimin e hapësirës për varreza në Bllacë? Ndërkohë që problemet me kanalizime e ndriçime vazhdojnë të jenë të mëdha dhe si duket ky buxhet nuk i adreson si duhet këto probleme. I çuditshëm është fakti se edhe këtë vit si në secilin vit prej se unë jam në Asamble, kemi planifikuar buxhet për ndërtimin e objektit të ri të komunës dhe e shkollës “7 Marsi” mirëpo asnjëherë nuk është bërë kurgjë. Ky planifikim ka mbetur veq në letër ndërkohë edhe këtë vit prap keni planifikuar buxhet për këto objekte por buxheti i planifikuar nuk mjafton as për me filluar punimet. Nëse e ke vërtetë për m’i ndërtuar këto objektet, hajde dhe e ke përkrahjen tonë sepse edhe komuna edhe shkolla “7 Marsi” kanë nevojë me qenë të reja dhe moderne. Ftoj secilin asambleist që ti themi jo këtij buxheti, me idenë që ta përmirësojmë e ta bëjmë një buxhet që mbron interesat qytetare dhe në një seancë tjetër ta shqyrtojmë e miratojmë bashkarisht.

Bajram Basha - përshëndet të pranishmit.Si pikë të rendit të ditës e kemi votimin e buxhetit që është shumë me rëndësi.Kam lexuar dhe i kam parë të gjitha projektete.Për disa projekte kam dal edhe në teren ku kam biseduar edhe me bashkë qytetarët për tema të ndryshme,si:shëndetësia,arsimi,bujqësia dhe projekte të tjera.Në fahtin Sllapuzhan pak është punuar.Te vorrezat janë shtruar 20 m kubëza në vitin 2019 ndërsa në vitin 2024 20 m asfalt. Propozoj të votohen këto projekte:rruga “Komandant Xhavit Sylaj”,segment “Zymer Basha”,segment “Xhemajl Basha”,rruga “Haxhi Shaqiri”,segment “Ruzhdi Elshani”,rruga “Martirët e fshatit”,segment “Idriz Elshani” dhe rruga “Faik Sylaj”,segment “Iagjja e Bytyqëve”.Kam dhe një pikë tjetër rreth QKMF-së në Suharekë.Në QKMF bëhet një punë e mirë dhe shumë profesionale.Si specialistët e mjekësisë familjare,mjekët dhe infermierët që bëjnë një punë të jashtëzakonshme dhe i përgëzoj për punën e tyre.Shërbimi i urgjencës punon 24 orë,bëhet një punë e jashtëzakonshme dhe është i përgaditur si stafi i mjekëve,infermierëve edhe shoferët të cilët bëjnë një punë të palodhshme.Brenda një viti në shërbimin e urgjencës vizitohen mbi 40.000 pacientë.Gjatë muajit korrik dhe gusht ka qenë një fluks i madh i pacientëve për shkak të patologjive të ndryshme duke i përfshirë të gjithë grupmoshat ndërsa këtu Urimi vje me fotografi,Laureta.Çka merr vesh për mjeksi Urim Suka,Aziz Bytyqi!Këta vijnë këtu me:shpif,shpif se diçka del.Këta merren me punë të njëanshme dhe të ndryshme.Asnjëri nga ju s’ka ardhë me vizitu Mjeksinë familjare.Andaj duhet të jemi më të përgjegjshëm dhe ndërgjegjshëm.

Urim Suka - e falenderoj doktorin dhe sido çoftë është mendimi i tij.Unë nuk kam pru foto fare.Tema që kemi ngrit ka qenë shqetësime qytetare siç i ngrisim çdo Asamble.

Bajram Basha - shyqyr ti që je për qytetarët,me qytetarët,te qytetarët.

Laureta Tafaj - fillimisht nuk më duket kjo temë për buxhetin që është duke u diskutu sepse ke pika e buxhetit.Megjithatë me doktorin nuk kam asgjë për me thënë dhe Drejtoresha e Shëndetësisë shpresoj me na sqaru këtë çështje se a ka pas të drejtë pacienti me marr infuzionin në oborr apo jo.

Bajram Basha - fluks i madh ka qenë,ka mundur të jenë edhe dy pacient me një shtrat.Ka dal ai vet,e ka inqizu dikush dhe këta me syreta vin këu.

Selman Kolgeci - pyetja që po e shtroj sa herë kemi të bëjmë me buxhetin dhe që nuk po përgjigjeni asnjëherë, tash që po e shtroj në këtë seancë kur po shqyrtohet buxheti i vitit 2025 është se mbi cilin kriter po i ndani mjetet për rrugët të cilat janë pjesë e projekcionit buxhetor.A dihet gjatësia e tyre? A dihet cilat pozicione kanë me u realize aty?Mbi bazën e kujt po i ndani këto mjete?Tash e keni kontratën për hartimin e projekteve dhe nuk keni pse arsyetoheni për mungesë të projekteve dhe përkundër kësaj unë po shoh që shumta të ndame për projektet kapitale janë shumta fikse dhe s’e kuptoj që si ka mundësi projektanti ti rezultoj të gjitha planifikimet me shumta fikse si:50.000,45.000,60.000,70.000.Nuk e kam të qartë nëse vlerat iu kanë përshtat projekteve apo planifikimet në ato projekte kanë rezultu çuditërisht vlera fikse sipas shpërndarjes paraprake që i keni bërë në kornizën afatmesme buxhetore në qershor të këtij viti.Investimet që do të realizohen në vitin 2025,a do të implementohen në bazë të projekteve që do të duhej të përpiloheshin para se të përpiloheshin ky buxhet apo përsëri edhe ky buxhet nëse miratohet do të ketë fatin e njëjtë me planifikimet tjera buxhetore dhe do të kalojnë këtu sa për procedurë e në fund do të ndryshohet edhe vullneti i asambleistave dhe do të deformohet vendimin i Asamblesë komunale.Për këto që ngrija marr shkas nga disa projekte që i gjej të përsëritura edhe këtë vit edhe pse vitin që jemi është dasht që këto projekte me qenë duke u realizu.Bëhet fjalë për ndërtimin e rrugëve lokale”Izet Shefketi” në Doberdelan,ndërtimi i rrugëve lokale “Ali Zogaj” në Jvor,ndërtimi i rrugëve lokale”Bashkim Kabashi” në Leshan,ndërtimi i rrugës lokale’Afrim Buqa” në Luzhnicë,ndërtimi i rrugës lokale”Demajt” në Nishor, ndërtimi i rrugës lokale,rruga Stravuqinë-Muhlan,ndërtimi i rrugës lokale”Ushtari i Lirisë” Vërshec, ndërtimi i impiantit për ujëra të zeza në Dubravë,ndërtimi i impiantit për ujëra të zeza në Sllapuzhan.Të gjitha këto projekte janë në vitin 2024, janë në plan të prokurimit dhe është dasht me qenë duke u ekzekutu punimet në teren dhe ju i keni pru edhe për vitin 2025 dhe nuk bëhet fjalë për kontrata 2 vjeqare. I keni planifiku 50.000€ për blerjen e aparaturave të nevojshme për QKMF -në “Rexhep Kuçi” në Suharekë .Shumë mirë,edhe pse ju keni thënë që shëndetësia në Suharekë është më e mirë se në Francë dhe ne e dime që nuk është.E di që ka nevojë me u investu në aparatura por është mirë me cek cilat aparatura.A ka aparatura që i kemi ble me pare të qytetarëve dhe janë t’u nejt në QKMF dhe nuk përdoren? Ndarje tjetër buxhetore për shëndetësi është ndërtimi dhe rikonstruimi i QMF-së në Suharekë,

QMF-ve dhe AMF-ve në Reqan dhe Gjinoc, janë 110.000€ për këto. Sa i përket AMF-së në Reqan, ajo nuk është funksionale. Nuk jemi kundër me pas sa më shumë vende ku qytetarët me marrë shërbime shëndetësore por fillimisht është mirë me na dhënë një arsye se pse është mbyll ajo dhe cila është garanca që pas këtij renovimi ajo AMF nuk ka me u mbyll prap. Sa për dijeni Kryetar, ditëve të fundit e kam pranë një fotografi ku na tregon gjendjen e asaj AMF-je. Është shqetësuese prania e qenëve endacak për ne por për ju nuk ish shqetësuese sepse nuk kishit parapa buxhet për trajtimin e qenëve endacak. Keni planifiku investime në rrjetin e ujësjellësit në Papaz dhe Sllapuzhan dhe është mirë që po shpërndahet rrjeti i ujësjellësit por dua të informohem nëse këto dy fshatra kanë marrëveshje me Hidroregjionin. Është e vërtetë që kam kërku disa herë këtu që me zgjeru rrjetin e ujësjellësit në fshatin Vraniq dhe ti ke thënë që nuk mundesh me investu aty sepse nuk jeni në hidroregjion. Tash shumë mirë që po qon investime në Papaz dhe Sllapuzhan por edhe ato nuk qenkan në Hidroregjion dhe ti po bën një fare ndasie këtu. Në Sllapuzhan a keni gjet burim të ujit se prej ku ka me u furnizu ky fshat me ujë apo vetëm e keni me kalu si procedure? As këtë vit nuk ka ndarje buxhetore për varrezat në Vraniq. Kryetar, jeni i informuar mirë për nevojën emergjente që ka fshati Vraniq për varreza të reja. Kemi kërku disa herë që të investohet në atë parcelë dhe të jetë e gatshme për përdorim, nuk kërkon investim të madh. Duhet pastrim nga shkurret dhe ndërtim i rrethojave përgjatë perimetrit të parcelës. E kemi thënë dhe ta kemi bërë me dije që secili bashkëvendas i imi që vdes atje, i meriton prej pronës shoqërore që e kemi atje. Siç e din edhe ti që në varrezat aktuale shumë shpesh varrëmihësi deri sa është duke e hap varrin e ri, i njerr eshtrat e varreve të vjetra dhe kjo nuk është njerëzore. Kjo që po bëni ju nuk është qeverisje, kjo është hakmarrje, abuzim me shtetin. Ne nuk po kërkojmë prej parave tua të gjepit me investu aty por po i kërkojmë taksat tona që i paguajmë komunës me na u kthij në investime ku ne kemi nevojë. Shpresoj që ky keqplanifikim dhe ky keqprojektim mos të kaloj në mënyrë që ky dokument ti nënshtrohet disa ndryshimeve të nevojshme ashtu që me qen në funksion të rritjes së mirëqenies të qytetarëve tonë, në funksion të përmirësimit të infrastrukturës e në funksion të projekteve tjera që i shërbejnë qytetarëve në përgjithësi.

Elmaze Bytyqi - përshëndet të pranishmit. Tek tabela e investimeve kapitale që është e bashkangjitur në këtë material, është një mospërputhje te rubrika e investimeve kapitale të kësaj liste me listen e kornizës afatmesme buxhetore që e keni sjell në qershor të këtij viti. Me projekt-buxhetin e vitit 2025 janë parapa 6.505.140 € në investime kapitale ndërsa në KAB 2025-2027 kanë qenë 6.600.000€. Dua një sqarim nga z. Fadil Hoxha apo nga Drejtori i Financave z. Halitjaha se shkurtimi i kësaj shume cilat projekte i cenon, a është larguar ndonjë projekt dhe nëse po, cilat janë ato projekte?

Labinot Halitjaha - përshëndet të pranishmit. Te ndryshimi kësaj vlere të vogël, këtë ndryshim e ka bë Ministria e Financave ku i ka bartë të hollat nga investimet kapitale te pagat dhe shtesat për mos me pas problem në paga dhe shtesa në vitin e ardhshëm. Te puna e cenimit të projekteve kapitale nuk ka ndryshu pothuaj asgjë sepse e kemi bë një zbritje të përgjithshme nëpër krejt projektet.

Liridon Fandaj - përshëndet të pranishmit. Ky buxhet nuk përmbush kërkesat qytetare. Gjatë dëgjimeve publike është vërejt një numër shumë i vogël i qytetarëve që kanë marrë pjesë në ato dëgjime publike. Poashtu edhe një numër shumë i vogël i asambleistëve duke përfshirë edhe veten që unë kam marrë pjesë vetëm me një dëgjim publik. Ne jemi të zgjedhur të qytetarëve dhe do të duhej të ishim në dëgjime publike dhe ti jepnim kritikën që sot ky buxhet të votohet por nga mos përgjegjësia e ekzekutivit duke marrë parasysh vitet e kaluara dhe nëse i pyet qytetarët asnjëra nga kërkesat e tyre në dëgjimet e kaluara nuk është inkuorporuar në buxhet. Andaj është e paarsyeshme të marrin pjesë ata ku një kërkesë e vetme nuk merret për bazë. Në lokalitetin ku unë kam qenë në dëgjim publik, konkretisht në fshatin tim, nëse e marrim procesverbalin asnjë nga kërkesat e qytetarëve nuk është në buxhet. Nëse ju doni me bo një buxhet, atëherë mblidhni kryetarët e fshatrave dhe le ti sjellin vet propozimet dhe mos i bëni dëgjimet publike. Si i tillë ky buxhet është sjell edhe me disa ndryshime. Ne edhe në puntorinë që kemi pas me KPF-në janë disa ndryshime, p.sh. nëse unë kam kërku që në fshatin tim ta kem projektin e ujit, nuk është fut në buxhet. Kolegu nga opozita që sot e kundërshton këtë buxhet, i ka pas disa propozime, janë inkuorporu në buxhet dhe sot prap po e kundërshton. Nëse jemi të barabartë para qytetarëve duhet m'i marrë parasysh të gjitha kërkesat e qytetarëve. Pa u lëshu në projekte kapitale që disa janë të tenderume edhe më herët, vota jonë është kundër për këtë projekt-buxhet.

Aziz Bytyqi - përshëndet të pranishmit.Sot në këtë seancë po diskutojmë për dokumentin më të rëndësishëm për qytetarët tonë,për buxhetin e vitit 2025.Kemi arritur në këtë fazë pasi janë realizuar mbi 20 takime publike me qytetarët të cilët kanë adresuar kërkesat e tyre,poashtu pas shumë kërkesave që janë dërguar nga qytetarët në institucionet kompetente komunale.Me ftesë të kryesuesit dhe me mbështetjen e OSBE-së jemi takuar me 7 shtator ku kanë qenë prezentë shefat e grupeve,Kryetari,Drejtorat,zyrtari ligjor,zyrtar financiar dhe përfaqësuesi i OSBE-së.Në atë takim gjithësecili nga ne kemi pas mundësi për të bërë propozime,ndryshime në draft buxhetin e paraqitur.Është për ta theksuar se në këtë takim shefi i grupit të LDK-së në fjalën e tij ka lavdëruar ekzekutivin për përgaditjen e mirë të buxhetit.Sipas tij ky është buxheti më imirë i përgaditur në vitetet e fundit.Ai nuk pati as një vërejtje as sa i takon shpërndarjes nëpër vendbanime e as për projektet e propozuara duke sjellur vetëm dy kërkesa të reja,konkretisht rregullimin e rrugës Rasim Ramadani dhe rregullimin e rrugës Tahir Ademi në Nishor.Ndërsa unë kam pas vërejtje edhe sa i takon shpërndarjes së buxhetit por edhe kam bërë propozime konkrete.Psh. propozim i imi ka qenë segment në rrugën“Gjergj Nikolla” ku jetojnë 15 familje dhe rruga është 250 m dhe sot është pjesë e buxhetit.Sa i takon shpërndarjes së buxhetit kam kërkuar dhe insistuar që fshatit Nishor ti rritet buxheti sepse meriton më shumë.Me 9 shtator jam takuar me Kryetarin,Kryesuesin,Drejtorat Enver Shabani,Visar Kuçi dhe Zyrtarin Financiar.Pas argumentimit tim, buxheti nga 20.000€ rritet në 50.000€ për vitin e ardhshëm dhe me këtë rast falemnderoj ekzekutivin në përgjithësi dhe Kryetarin në veqti që më kanë mirëkuptuar dhe e kanë mbështetur kërkesën time.Faleminderit në emër të gjithë qytetarëve të Nishorit.Po në këtë takim me të lartpërmendurit,pasi me kërkesën e qytetarëve në Bllacë kam vizituar rrugën Shkodra,kam kërkuar të rregullohet në vitin e ardhshëm dhe e cila është sot pjesë e buxhetit.Mund të konstatoj se me këtë buxhet në përgjithësi janë planifikuar për vitin e ardhshëm të kubëzohen e asfaltohen mbi 100 rrugë me mijëra metra katror,do të vendosen e rikonstruohen shumë kanalizime,ndriçime,parqe e shumë projekte tjera,të gjitha në interes të qytetarëve pa asnjë dallim.Mua më duket jo qasje serioze,një imazh me pas kur janë kamerat e një imazh tjetër me pas kur s’janë kamerat!Bën dy propozime konkrete për dy rrugë dhe të dyja në pjesë të buxhetit dhe tash bën thirrje për mos votimin e buxhetit brenda së cilës janë propozimet e tij dhe kjo më duket e pakuptimtë.Pse opozita mos m’i pru në fazat paraprake 100 propozime dhe në këtë formë me luftë rolin që i takon.S’po flas për Liridon Fandaj i cili ka pas vështrim kritik për buxhetin.S’po flas për Dardanin,megjithëse Dardani pat vetëm superlativë.Sinqerisht asnjë votë nuk e humb kurrë opozita nëse e voton buxhetin përkundrazi është në avantazh moral dhe publik me dal me vajtu për cilësinë e atyre rrugëve.Ju bëj thirrje të gjithë anëtarëve të Kuvendit që ta votojnë buxhetin,që të bëheni pjesë e vendimmarrjes për çka ju kanë zgjedh qytetarët.

Urim Suka - Aziz faleminderit!Jam pak i habitur me këto sulmet që po vin drejt meje por si do që të jetë unë e vlerësoj mendimin tuaj.Unë kam fol që tri vite dhe Azizi asnjëherë në këtë formë nuk m’u ka drejtu.Krejt ky propozim po del që unë i paskna propozu dy rrugë në Nishor dhe koka prek Azizi pse unë i kam diskutu ato rrugë në Nishor.Kërkoj falje por mua më kanë thënë njerëzit atje me i ngrit këto shqetësime.Azizi tha:ai nuk pati asnjë vërejtje për buxhetin.Besoja ka pas proces dhe le t’mi listoj të gjitha vërejtjet që i kam dhënë unë për buxhetin.Unë kam dhënë shumë vërejtje atë ditë për buxhetin dhe kam propozu edhe për Javor rrugë tjetër dhe propozime tjera.Buxheti për Nishorin nuk u rrit pse Aziziz ka ndiku por u rrit buxheti për Nishorin se unë kam shku i kam propozu dhe që ky ka mujt ato propozime para meje m’i bo dhe nuk i ka bo.Pse opozita nuk bën propozime? Për atë unë kam ardhë në atë takim,për me bo propozime,për me pas një buxhet ma të mirë dhe plot propozime kam bërë,edhe plot vërejtje.Buxheti që e keni pru sivjet është tri herë më i mirë se buxheti që e keni pru vjet por kjo nuk do të thotë që duhet me kalu sepse ti listova krey vërejtjet pse s’duhet me kalu.Për me ta argumentu edhe një çështje tjetër dhe nëse don me mbrojt interesin qytetar,si ta kryejmë Asamblenë shkojmë dhe e shohim hapësirën për varreza.Qe tri vite planifikohet hapësira për varreza dhe betoni atje është 4 m i lartë.

Aziz Bytyqi - keni qenë të gjithë prezent dhe sinqerisht asnjëherë unë nuk gënjejë.Dy propozime konkrete i ke pas.Të dyja i ke në buxhet.Rritja e buxhetit në Nishor ska lidhje me propozimet e tua sepse ti nuk ke kërku me u rrit buxheti në Nishor po i ke kërku dy rrugë.

Jehona Rrafshi Lumi - detyra ime si asambleiste është që ti adresoj kërkesat e qytetarëve.Ky buxhet po shpërndahet te qytetarët tonë por paraprakisht pash një gabim teknik te fshati Duhël dhe Bllacë ku rruga

“Kukësi” është e përfshinë në të dy fshatrat por i përket vetëm Billacës, kështu që në fshatin Duhël të zëvendësohet me rrugën “Komuna” dhe të bëhet renovimi i rrugës “Rrafshi”.

Vullnet Luzhnica - përshëndet të pranishmit. Normal që opozita i ka shqetësimet e veta dhe si asambleist pozitive ne mendojmë që buxheti është i mirë dhe opozita e ka detyrën e vet. Normal që nuk është i kënaqshëm dhe për atë duhet me nxjerr një mesatare që ne mendojmë që është i përgjithshëm, andaj edhe besojmë që ne me programet zgjedhore garojmë dhe fitojmë dhe në fund të fundit vjen tetori i vitit të ardhshëm dhe na tregon përsëri elektorati se kush ka të drejtë e kush gabim por mos pritni që ne me program të juajin duhet me kalu buxhetin sepse ne kemi garu me program tonin. I ngrit disa vërejtje Urimi dhe dua të them që rruga “Qarri” dhe rruga “Bashkimi” janë të rëndësishme në Greiqec me u kry dhe besoj pajtohesh edhe ti. Në Luzhnicë ka pak të pavërteta dhe unë të kam thënë edhe atëherë dhe po të them edhe tash: Luzhnica ka kryetar fshati dhe ti prej krejt Luzhnicës ke zgjedh njerëz jasht Luzhnicës me vizitu Luzhnicën dhe për atë del keq sepse në Luzhnicë ka segmente. Në Luzhnicë ne i kemi 10.000€ buxhet dhe kemi vendos me bo segmente. Të ftoj publikisht me ardhë me i pa. Rruga “Ali Zogaj” në Javor është rrugë e cila i takon familjes Zeqiraj e që ne e kemi planifiku pasi ta mbyllim rrugën që jemi duke e përfundu sivjet dhe besoj që është e nevojshme dhe besoj që e keni ngrit edhe ju.

Shefket Kolgeci - përshëndet të pranishmit. Vërtetë këtë buxhet e kemi analizu mjaft mirë. Unë e kam një vërejtje konkrete ku në projekt-vendim nuk është përfshi kanalizimi në fshatin Vraniq. Para dy-tre vite e kemi kry një kanalizim por ai kanalizim nuk funksionon. Unë kam kërku para tre muajve që të formohet një komision në nivel të qeverisë komunale por atëherë ka qenë Agimi Drejtor dhe nuk është ndërmarr asgjë. E dinë edhe Kryetari për problemet që janë dhe unë mendoj që duhet të ndahen mjete për atë kanalizim dhe të shkohet aty ku ka defekte me u riparuar. Shumë herë kemi ngrit shqetësimin këtu për këtë kanalizim dhe propozoj që gjithëqysh të ndahen mjete për atë kanalizim. Andaj një prej faktorëve për mos me votu këtë buxhet është edhe ky kanalizim që nuk e keni parapa fare në buxhet. Nuk e di drtejtori që ka qenë a ia ka përcjell drejtorit të ri por kjo është e domosdoshme dhe më mirë është me lënë një rrugë dhe mos me shtriu dhe me bo funksional atë kanalizim, mendoj unë dhe qytetarët ashtu kërkojnë. Azizi tha: pse nuk keni ardhë me kontribu. Për hartimin e buxhetit, ne gjithmonë përpara kur kemi qenë në pushtet i kemi ftu shefat e grupeve parlamentare, u harmonizu buxheti. Unë po e shoh neglizhencë të Kryetarit dhe a është neglizhencë apo ka mendu diçka tjetër, është çështje e tij por gjithmonë buxheti duhet të konsultohet me grupet parlamentare, opozitën. Edhe numrat kur ti ke duhet të konsultohet me opozitën, andaj edhe unë jam me grupin parlamentar që do të jemi kundër këtij projekt-buxheti.

Laurtea Tafaj - përshëndet të pranishmit. Zakonisht gjatë tërë vitit fëmijëve ju thojnë: shkruni dëshirat me një letër dhe në fund babadimri iu bjen dhuratat. E këtu dikush është duke e lujt rolin e babadimrit që nuk vjen kurrë e kush është krejt e dimë. Kam respekt për ty Aziz por desha ti citoj dy frazat e tua: “S’ e di ku e ke lexu, opozita nuk bën me votu buxhet”. As unë nuk e di ku e keni lexu që pozita duhet patjetër me votu buxhet. Fraza tjetër: “Ne jemi këtu sepse ata janë atje”. Po, mos t’ishin ata atje, ne nuk ishim këtu. Deri sa ata janë atje edhe ne kemi shku, i kemi dëgju kërkesat e tyre e sot nuk po i shohim këtu, nuk mundemi pro buxhetit që e keni bërë ju e jo qytetarët.

Flamur Bytyçi - përshëndet të pranishmit. Përveq që unë nuk pajtohem, ka shumë gabime në këtë material për të cilin ne po diskutojmë por me çka nuk pajtohem është çasja e kolegut Aziz për të cilën unë mund t’ia dëshmoj, me një fjalë qysh e tha që ne nuk jemi akter dhe s’kemi qu propozime dhe s’kemi marrë pjesë. Është e pavërtetë kjo dhe ta tregoj edhe numrin e protokollit me të cilën unë iu kam drejt Kryetarit përmes Kryesuesit dhe i kam bërë propozimet e mia dhe asnjëra prej propozimeve nuk ka kalu. Prej 16 pikave unë po e cekim vetëm njërin e cila është më e rëndësishme që unë e kam propozu, është funksionalizimi i bazenit në fshatin Peqan që prej 2018 ata janë pa ujë.

Liridon Fandaj - në bazë të asaj që tha Azizi, më duket që shumë po lexon ky dhe Albani por lexoni më pak e punoni më shumë. Urimi atë ditë më ka befasu në puntori kur e ka lavdu buxhetin por i ka pas disa kritika që në fund dol e kundërta me atë që e lavdoj, por e ka pas edhe një propozim tjetër që nuk iu ka miratu. E ka propozu m’i ju hek rruga e vet që është në buxhet dhe atë s’e pash që iu ka hek. E ka edhe një kërkesë për varreza por më e arsyeshme është kërkesa ime që e kam pas për ujë.

Selman Kolgeci - ato që i tha Azizi, mendoj që krejt ata që e morën fjalën për replikë e demantuan e në veqanti e demantoi Vullneti sepse Azizi tha se pse nuk po i sillni projektet e juaja ndërsa Vullneti tha se

çka po pritni ju, a po pritni që ne kemi me kalu programin e juaj.Është mirë me i harmonizu këta dy mes vete fillimisht dhe me dal me një fjalë.A e din se pse nuk e votojmë Aziz?sepse ty ta ka thy vullnetin ky. 35 projektet e vitit 2023 që i ke votu ti me dorën tënde ,nuk t'i ka realizu.Nuk është e vërtetë që nuk kemi pru projekte.Si po pret me ta votu projektin kur ti asnjërën prej shqetësimeve tona që i kemi marrë prej qytetarëve,nuk i ke përfshi në projekt.E di që patjetër nuk është opozita me votu kundër projekt-buxheti por duhet projekt buxheti me ia ga ngjarjeve dhe nevojës në teren.

Kushtrim Kuçi - e kemi bënë një peticion rruga “Hajdin Berisha” dhe e kemi dorëzuar te DSHPE për rregullimin e kanalizimit me arsyetimin për shkak që numri i ndërtesave po rritet në atë pjesë,është i papërbalueshëm.A keni parapa diçka në këtë drejtim dhe a do të merrni masa?

Reshat Selimaj - përshëndet të pranishmit.Ne të gjithë e dime që dikush është për herë të katër këtu,dikush për herë të dytë,për herë të parë,por Keti e din më së miri që është veteran këtu që ky buxhet për mu planifiku,duhet me fillu nga marsi.Keti dhe Urimi po e bëjnë një politikë:hajde ti kërkojmë e ti sfidojmë.Unë e di që në fushat çka ke premtu për Grekoc por ti e din mirë edhe unë çka kam premtu dhe qytetarët kanë zgjedh.Mos prit që unë ti kry ato që ti ke premtu sepse unë kam dal me ofertë t'imen dhe ti tënden dhe i kemi provu forcat.Kam dëshmitar këtu që unë dy herë ia kam votu buxhetin Sali Asllanit.Në sa dëgjime publike ke marrë pjesë ti dhe Urimi? Ne e kemi formu një komision për ujësjellës dhe ti që 18 vite je duke e përdor këtë ujësjellës për fushatë.Nuk ia ke kallzu realitetin qytetarëve atje që në momentin kur investon hidro regjioni,kalon katuni me pagesë.Mos e përdor më sepse është bënë demode kanalizimi,ujësjellësi.Shko kallzoju drejt dhe kaloje ose në regjion ose investoni si katund dhe mbane vet.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

**16 për,14 kundër,1 apstenim
Miratohet pika 2**

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Urim Suka - kjo parcelë për të cilën po flasim e ka një histori dhe janë disa vite që kjo është duke u shfrytëzuar dhe deri tash kemi pas një mori ankesash që kanë ardhë drejt nesh.Shumë prej temave ne i kemi ngrit edhe në Asamble.Edhe unë e kam ngrit një herë këtë shqetësim dhe drejtori Enver Shabani më ka thënë që është e vërtetë që aty është mbush ajo pjesë por kontratë kemi edhe një vit dhe pasi të skadoj kontrata duhet me bënë një alternativë tjetër sepse është vend ku nuk duhet me vazhdu më me shfrytëzuar për këtë qëllim që po flasim,për me i hudh mbeturinat atje.Mirëpo çuditërisht tash na ka ardhë projekt-vendimi për me dhënë pëlqimin për me inicu prap atë pjesë.Duke i marrë për bazë të gjitha shqetësimet,duke marrë për bazë për mënyrën se si është menaxhu ajo pjesë dhe dëmet që janë bënë atje normalisht që ne si LDK jemi kundër këtij vendim.Në atë zonë nuk bënë me hudhë mbeturina për shkak që edhe është tejmbush dhe kërkojmë nga ekzekutivi që me një vendim të ardhshëm me gjet një hapësirë tjetër e cila do ti përmbushte këto nevoja dhe pastaj jemi për me përkrah dhe m'i dhënë zgjidhje kësaj problematike sepse e dime që patjetër duhet me pas një pikë grumbulluese të këtyre mbetjeve.

Armend Krasniqi - përshëndet të pranishmit.Pajtohem me një pjesë të Urimit për disa probleme të cilat ndodhen aty sepse kemi pas disa ankesa për ato që tha mirëpo komunës së Suharekës i duhet një emergjencë për krijimin e një depo ku munden me u hudhë mbeturinat e ngurta.Faktikisht kontrata i ka skadu dhe u mbyll disa ditë sepse nuk ka profite të mëdhaja edhe aty.Me shku dhe me shiku se si qytetarët i hudhin mbeturinat është krim edhe për ambientin edhe për qytetarët të cilët jetojnë rreth zonës industriale dhe rreth fshatit Studenqan.Fillimisht kur është dhënë kjo kontratë edhe unë kam qenë kundër mirëpo tash duhet me qenë pro të gjithë sepse duhet me kriju një alternativë momentale për një vit,dy ose pesë me kriju dhe me kontrollu sepse ajo ka me qenë e pakontrollueshme dhe ka me dal jasht kontrollit dhe është diçka e rrezikshme që mund të shkaktoj dëme të mëdhaja të ardhmen sepse është e pamundur m'i ndalu qytetarët për m'i hudhë mbeturina aty.Pajtohem që the që duhet me intenzitet të lartë me gjet edhe një vend tjetër për ti krijuar alternative qytetarëve për me i grumbullu këto mbeturina dhe duhet

marrë me seriozitet këtë çështje.

Urim Suka - pajtohem me drejtorin me shumicën e rasteve që i ngriti. Unë e thashë që ne jemi të interesuar për me dhënë kontributin por jo në atë vend për arsyet që i thashë. Nuk mundet me u justifiku që tash u mbyll ajo kontratë dhe u bë ajo katrahurë. Komuna duhet me funksionu, duhet me dal që mos me u bë ajo katrahurë.

Armend Krasniqi - unë i kisha lut që me mbyll atë 1-2 javë dhe do ta shohim a mundet me ndalu komuna ose dikush tjetër. Nëse e mbyllim një deponi, mbane në mend që kanë me u hap 50 deponi brenda muajit. Kjo është më se emergjente të krijohet një alternative dhe shpresoj që dikush konkuuron.

Urim Suka - drejtori ose kush do që e ka pas përgjegjësi nuk është dasht me prit me kalu kontrata. 3-4 muaj përpara, para se m'i kalu kontrata është dasht m'u nis kjo procedurë. As nuk i ka nis procedurat me kohë dhe as tash nuk po veproni për me nal atë katrahurë.

Armend Krasniqi - pajtohem me ato që i the më parë. Kemi marrë kontratën e kemi analizu dhe kemi shiku mos kemi ndonjë vend tjetër i cili është i përshtatshëm mirëpo ka qenë e pamundur me gjet një vend tjetër për këtë moment dhe nga më e keqja duhet me zgjedh ndonjëherë më pak të keqen.

Liridon Fandaj - kur jemi te kjo kontratë në bazë të asaj që është dhënë në kuvendin komunal ky lokacion është: destinim sipas vendimit të kuvendit komunal, lokacioni për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimin e objekteve ndërtimore. Nëse shkon në atë deponi më shumë ke mbetje inerte të kafshëve e tjera produkte se sa kjo që është e destinuar. Kjo deponi nuk është menaxhu si duhet dhe edhe pse ka përfundu kontrata dikush është duke e menaxhu atë. Dje kam shku në deponi dhe unë kam qu mbetje ndërtimore por askush nuk është kujdes a kam mbetje ndërtimore aty apo nuk kam. Edhe asamblenë e kaluar e kam ngrit si shqetësim që disa qytetar edhe përmes mediave kanë dalë që nga ajo deponi kanë pësuar infeksion për shkak të kundërmimit të ernave dhe mbetjeve që janë hudhë aty. Nëse ajo deponi nuk i plotëson kushtet, ajo duhet të mbyllet por jo të vazhdohet dhe të jepet e njejt deponi. Duhet edhe inspeksioni ta mbyllte atë deponi në momentin që dikush është anku për një infeksion por asnjë masë nuk është marrë, andaj ne nuk do ta përkrahim dhe jemi kundër këtij vendimin.

Armend Krasniqi - Nuk dua ta mbroj këtë çështje sepse mua më së shumti më dëmton sepse jam nga ajo rrethinë mirëpo hajde dhe prej sot po e gjejmë një vend tjetër mirëpo mbyllja e asaj deponie ka me kriju skandal në komunën e Suharekës.

Liridon Fandaj - të kuptoj drejtor por të paktën ajo kontratë që është nënshkru duhet të respektohet. A ka mbetje tjera? A është dasht me marr masa ndaj tyre?

Kryetari - unë ju kuptoj plotësisht. Ju duhet ta dini që në komunën e Suharekës pronat janë privatizu dhe jemi të rrethekuar me agjensionin e pyjeve. Ne kemi tentu me gjet por nuk ka mundësi me gjet. Edhe ne jemi të vetëdijshëm por më mirë me pas një se mos me pas hiq. Ne e kemi bërë pastrimin e deponisë në Bllacë te mrizi por prap e kanë mbush. Është me PZHK, me HZK. Aty ka mundësi edhe 5 vjet me punu bagerat, me u rrafshu dhe aty në fund ka me u mbjell bari. Nëse e gjeni ju, ne menjëherë e bëjmë gati dhe dalim në Asamble dhe ajo kompani që e merr, le të kalon atje dhe ne e ndërprejmë kontratën. Liridoni plotësisht ka të drejtë. Kryetari tutje jep sqarime sa i përket kësaj pike.

Kryesuesi - e hedh në votim vendimin që të jepet në shfrytëzim për 5 vite.

**18 për, 7 kundër, 2 apstenime
Miratohet pika 3**

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për lirim nga taksa në aktivitete;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Shefket Kolgeci - unë mendoj që ky vendim është i mirë dhe i domosdoshëm dhe ne si grup parlamentar e përkrahim. Ne e kemi pas një kërkesë disa herë në Asamble por nuk është aprovu që taksa në aktivitete të hiqet për të gjitha bizneset. Andaj unë kërkoj që propozimi i grupit parlamentar të LDK-së të hudhet në votim nga që e vetmja është komuna jonë që e ka taksën në aktivitete. Kërkoj nga kolegët asambleistët që të jenë të vëmendshëm dhe ta votojnë propozimin tonë.

Kryetari - kjo është pikë e rendit të ditës,e kryejmë e mandej ju propozoni sa të doni.Ne e kemi fal për këtë vit që qytetarët e komunës së Suharekës nuk paguajnë tatim në pronë.Ky është mandati i dytë,viti i tretë dhe çdo herë e keni kundërshtu por faleminderit prej të gjithëve sepse në demokraci ka pro dhe kundër.Ato që i ke fol,nuk është ashtu.Në fshatin Javor kanë qenë të propozuara dy por me mjetet që janë nda s'po kryhet një dhe atë ke me pas në buxhet për vitin 2025.Në Doberdelan dy janë kry dhe ky ka mbet për vitin e ardhshëm.Rruga Seferi është kry vitin e kaluar 1.3 km dhe 8 vëllezërit është në kufi me Shtimjen dhe vetëm një villë është dhe s'ka rrymë.Rruga "Skënderbeu" është kry komplet infrastruktura nëntokësore dhe ka kërku KEK-u gypa dhe i kemi vendos mirëpo është një problem financiar që vlera është shumë e madhe për shkak të kabllave nëntokësore.Takimi është caktu sot dhe kërkoj falje sepse më duhet të shkoj.

Liridon Fandaj - në KPF e kam mbështet këtë vendim por në komision kam kërku një raport që në pjesën e rrugës"Senderbeu" me u evidentu cilat biznese janë aty,dhe te pjesa prej urës e këndej.Ne sot nuk e kemi atë raport edhe pse unë kam dasht me votu atë por është shumë e palogjikshme sepse unë e ndërroj adresën për 2.50€ dhe përfitoj në taks 500€ në biznes.Nëse nuk evidentohen këto,lëmë hapësirë për m'u keqpërdor ky vendim.Për deri sa nuk është sjell një raport që kam kërku,vota ime do të jetë apstenim.

Labinot Halitjaha - përshëndet të pranishmit.Besoj që ka me qenë një vendim i mirë me iu ndihmu bizneseve.Ne si drejtori i kemi identifiku bizneset në të dy rrugët dhe janë rreth 50 biznese që arrijnë vlerën 11.335€ në taksë komunale dhe te brigada 123 janë 33 biznese që arrijnë vlerën 7000€ për një vit. Nëse merret vendimin,ne si drejtori e bëjmë zbritjen e taksës komunale për vitin 2024-2025 dhe ata që e kanë pagu vitin 2024 do të transferohen në vitin tjetër.Nëse i heqim edhe taksën në aktivitet të cilën e kërkon që sa herë,atëherë ne si asambleista dhe si qytetar po kërkojmë që të rritet buxheti në çdo fshat dhe çdo vend dhe këndej kërkojmë që ti heqim të hyrat vetanake që janë mundësia më e mirë për investime,unë nuk e di ku kemi me marrë të holla për investime.

Shefket Kolgeci - vetëm Suhareka e ka.

Liridon Fandaj - po e marr shembull një biznes.Ipko ka qenë andej urës dhe ka dal këndej.A përfiton ai apo jo sepse ka një muaj që ka dal ndërsa bizneset tjera ka një kohë që s'janë duke punu.Nëse e ndërrom adresën dikush,kjo nuk është e logjikshme.

Labinot Halitjaha - ne i kemi verifiku të gjitha bizneset që janë ekzistuese në këto zona dhe besoj që edhe këto raste kemi me i verifiku dhe kemi me marrë një vendim.

Liridon Fandaj - dikush me këtë vendim nesër nuk e paguan taksën komunale dhe ti nuk ke çka m'i bë atij sepse ai e fiton lëndën në gjykatë.

Visar Kuçi - unë pajtohem me Liridonin por mund të jetë edhe një problem tjetër në këtë rast.Unë njoh biznese që e ka veprimtarinë në shesh apo në rrugën"Skënderbeu" por s'ka të bëj me atë adresë.Është mirë që në kuadër të këtij vendimin të bëhet një komision për me i verifiku bizneset që veprojnë në atë zonë.

Flamur Bytyqi - unë mendoj që vendimi është në rregull.Kur kanë qenë punimet më herët në shesh,a janë liru prej taksës në biznes që kanë qenë më herët të atakunë?

Labinot Halitjaha - unë po flas për periudhën time sa jam drejtor.

Kryesuesi - ka qenë koha e pandemisë dhe në atë kohë janë liru një pjesë.

Liridon Fandaj - ne do ta mbështesim këtë vendim nëse drejtori zotohet që t'na përcjell me email listen.

Selman Kolgeci - kërkoj sqarime nga zyrtari ligjor.A mundet ky vendim me prodhu një diçka tjetër në gjykatë nesër?

Avni Bytyqi - jo.Atë e tha edhe Flamuri.Nëse i refrohemi saktë vendimit,vendimin thotë: të gjitha bizneset që ushtrojnë aktivitetin dhe jo adresën.

Liridon Fandaj - listen e drejtorit të cilën e kam,janë disa biznese që i kanë dy aktivitete,njërën në rrugë "Skënderbeu" dhe tjetrën në rr."Brigada 123".Nëse ne e marrim këtë vendim ,atëherë ne po e lirojmë sepse ai ka dy aktivitete dhe është e njejta firmë.Ose duhet me nda për ato biznese që kanë ato aktivitete dhe me ia përgjysmu taksën,përndryshe ai në numër fiskal po përfiton për dy njesitë.

Labinot Halitjaha - nëse është që i ka dy njesi dhe nëse e ka njesinë kryesore apo bazë apo pjesën e dytë në selinë sekondare,ne kemi me ia verifiku cilën e ka aty dhe kemi me ia heq tarifën për njesinë që është reale.

Flamur Bytyqi - mua më duket padrejtësi që jemi duke i bë bizneseve tjera.Mendoj që është mirë krejt bizneset me i liru për këtë vit sepse edhe në të kaluarën ka pas raste kur janë kry punime por nuk janë liru prej taksave.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4.

17 për,13 apstenime
Miratohet pika 4

Kryesuesi kërkon që të bëhet me shkrim propozimi dhe e fusim si pikë të re.

Avni Bytyqi - të gjithë anëtarët e Kuvendit që kanë biznes në territorin e Komunës kanë konflikt interesi.

Pika 5.Projekt-vendimi për ndarjen e çmimit “Ukë Bytyqi”;

Kryesuesi - e laboron pikën dhe hap debatin.

Bulëza Kuçi - si anëtare e komisionit për ndarjen e çmimit “Ukë Bytyqi”,kam pas privilegjin të kontribuoj në procesin e përzgjedhjes së një figure të rëndësishme për komunitetin tonë.Ky çmim i dedikohet individëve që kanë kontribut të çmuar për komunën dhe qytetarët tonë.Përzgjedhja e z.Sali Asllanaj ishte e qëlluar dhe plotësisht e merituar.Si anëtare e komisionit dhe përfaqësuese e LDK-së e mbështesim fuqishëm këtë vendim dhe jemi krenar që LDK ka njerëz që lënë gjurmë të pashlyeshme në qytetin tonë.

Alban Berisha - përshëndet të pranishmit.Ky çmim pak për mua është emocionuese dhe normal që me mendje dhe me zemër do ta votoj pro por shpirtërisht pak jam kundra sepse po më duket që po e pensionojmë një akter politik që i ka dhënë shumë Suharekës.Megjithatë kjo ndoshta duhet me shërby si një shenjë që është një rast i tillë unikat në Suharekë që një Kryetar me nderu një ish Kryetar. Për mua është një gjest shumë i ulët kur periudha e fushatës 1 muaj përdoret tani 4 vjet sepse fushata është pak atraktive dhe të detyron nganjëherë edhe me dal prej vetvetës dhe me kundërshtarin me përdor fjalë që s’do duhej me i përdor por profesionistat politikë duhet me lënë këtë në kuadër të fushatës.Pse jam i emocionuar që po flas?E para është sepse po e shoh emrin e një bashkëpunëtori që e kam pas një kohë të gjatë dhe e dyta është që shumë fjalime shpesh i kam pas që mos me kalu ne në rrafshin personal.Të gjithë këtu kemi familjet.Vijmë këtu dhe shefi i grupit tonë e ka përgjegjësi politike prej degës tonë me shpreh mendimin e degës dhe nganjëherë edhe të vetin. Këtu është vendi për me fol dhe për deri sa ne e kemi të drejtën këtu me ardhë me fol.Nuk e di pse duhet me fol prej anash dikush dhe me thënë:boll,e teprove,mos fol më.Autoriteti që i thotë Urimit boll ose dikujt tjetër janë vetëm këta qytetarë që të kanë votu dhe kanë drejt zgjedhjet tjera mos me të votu. Asnjë autoritet tjetër këtu nuk ka të drejtë me më thënë mua mos e fol këtë ose e teprove ose s’ke fol,përveq kryesuesit që ka të drejtë kur të vje limiti i kohës me ta ndal mikrofonin.Ne jemi duke u marr me politikë moti dhe e tejkalojmë si të dalim prej kësaj dere por kemi familje që theren shpirtërisht kur ta nin dikënd duke ufendu,sepse dikush më ka prind mua,dikush e ka atë prind e dikush e ka fëmijë atë e dikush më ka mua dhe nuk kemi nevojë me kalu në rrafsh personale në atë që kush ka m’u shit,kush u shit dhe me kqyr njëri tjetrin se kush pe qon dorën e kush s’pe qon dorën.Është e drejtë themelore private dhe unë i përkas partisë së LDK-së.Si asamblesit shumë shpesh jemi në pozicione të kqija ku e ke një vendim që duhet me respektu dhe është një propozim përpara që është për mua i mirë.Ata kolegë sot janë në pozitë dhe nesër kanë me qenë në opozitë,shpresoj dhe punoj për këtë drejtim dhe le ta shohin edhe vet por e dinë disa që kanë përvojë.Tash,nëse mua më mban moral dikush dhe thotë:ti mos e ngo partinë,kqyre projekt buxhetin,pse atëherë ju si pozitë votoni top shpesh?Ju lutem mos e merrni personale.Ju kisha lut si koleg me pas pak respekt dhe mos me ardh në rrafsh personale.Ju lutem kolegëve,duke ia nis prej Qëndrimit që në aspektin emocional të ndjenjave mos me prek kërkan.E them këtë sepse vjet kur ka qenë seanca për buxhet unë kam qenë në Zvicërr,e kam pas vëllaun me cancer.Akuza ka pas se a m’ka ble Baliu mos me ardhë,a s’um ka ble?Nuk po them që Qëndrimi e ka pas për këtë por në shkrimin që e ka bë në facebook publike,ma ka prek ndjenjën shumë.E tash secili prej jush këtu keni familjar.Për atë e them që mos kaloni në rrafsh personale,merruni me politikë.Ju kërkoj falje por që po e them shprehjen sikur po ju mësoj, keni argument,keni me çka me u

marrë dhe mosni personalisht sepse secili jemi djat, bab, vëlla, motër i dikujt këtu. Personalisht unë më nuk kandidoj. Kemi m'u pa por mos ia prekni ndjenjat askujt.

Aziz Bytyqi - e mirëkuptoj qëndrimin e Albanit. Sa i përket pikës, në emër të grupit dhe në emër t'imin personal e mbështesim vlerësimin që i bëhet një ish Kryetarit të komunës për udhëheqje dhe ndihem mirë që jam pjesë e Asamblesë për ta votuar dhe personalisht e vlerësoj ish Kryetarin e komunës për kontributin e tij, intelektualitetin, kulturën e tij. Unë besoj që kjo është një traditë e mirë kur po i vlerësojmë ata që na kanë udhëhequr. E falemderoj komisionin, propozuesin dhe të gjithë ata që kanë ardhë në përfundim.

Kryesuesi - unë e kam biografinë e z. Sali Asllanaj por nuk kam çka me lexu kur ju të gjithë e dini, e njihni dhe e dini për kontributin e tij edhe në luftë edhe pas luftës. Është një propozim i qëlluar dhe ne si komision e kemi mbështet unanimisht.

Urim Suka - i jap gjithë mbështetjen dhe fjalën që e tha Albani le të fillon prej meje me kuptu më drejt dhe me pas edhe më shumë parasysh edhe pse unë përtej kritikës opozitare kam provu mos me i kthij gjërat personalisht dhe kurr nuk i kthej personalisht dhe me askënd s'kam asgjë personalisht por ligjerata e Albanit ishte për me reflektu për një zhvillim të demokracisë në nivelin sa më të mirë të mundshëm. Vendimi që ka ardhë na bënë krenar si LDK, na bënë krenar për rrugëtimin e LDK-së dhe përtej krejt katrahurës politike, akuzave që ndër vite janë thënë do ti kuptojmë si akuza që kanë qenë për qëllime politike dhe sot jemi këtu dhe ndihemi mirë që e kemi një propozim të tillë për me vlerësu një figure që në një formë në periudha të vështira ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për komunën tonë. Faleminderit dhe e përshëndesim këtë vendim.

Jehona Rrafshi - pavarësisht që nuk i përkas të njejtit subjekt politik, njerëzit e mirë dhe punët e mira padyshim që duhet të suportohen dhe unë jam pro këtij vendimin.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 5.

28 vota për, Miratohet Pika 5

Pika 6. Pyetje dhe përgjigje;

Urim Suka - pyetja e parë ka të bëjë me Drejtorinë e Kulturës por para kësaj unë dua ta shpreh shqetësimin që unë vazhdoj mos me marrë një raport që drejtoresh ka thënë që është gati.

Lorika Gashi - kërkoj falje. Ka qenë i gatshëm edhe muajin e kaluar por na ka dal nga mendja.

Urim Suka - tek unë kanë ardhë disa informata për subvencionet që janë nda për vitin aktual dhe ajo që dua të di nga ju është që kush nga këta përfitues që ju i keni nda, i ka marrë këto mjete dhe kush nuk i ka marrë dhe nëse mund të na njoftoni se pse nuk i kanë marrë dhe kur pritet m'i marrë? Pyetja e dytë ka të bëjë me DKA-në. Unë jam shumë i shqetësuar me situatën që po ndodh në DKA kohëve të fundit. Sot është 26 shtatori ndërsa 14 vende të punës ende janë në konkurs dhe me 30 shtator ata kanë me iu nënshtruar intervistës me gojë dhe në fakt ky proces është dasht të kryhet gjatë muajit gusht. Pse duhet me vazhdu drejtori me qenë në detyrë kur është gjithë kjo neglizhencë. A e din sa ora është duke u humb në shkollat tona për shkak se mësimdhënësit nuk janë rekrutu me kohë. Ndoshta drejtori ka arsyen e vet dhe le ta tregon por kjo është prej përgjegjësisë elementare që duhet me pas. Unë jam në shkollën e Bllacës dhe shkolla e Bllacës është duke punu me dy ndërrime dhe me një situatë të çuditshme për shkak të neglizhencës që punët nuk janë kry me kohë dhe kërkoj intenzitetin më të madh që kjo me u përmbyll.

Lorika Gashi - Urim mund ta bëj listen pa problem dhe besoj që edhe te thesari mund të gjindet lista. Shkaku i problemit me buxhet që e kemi pas gjithë komunat e Kosovës, konkretisht drejtorja ime dhe subvencionet janë prek prej përmbaruesit dhe në momentin e parë të rimbursimit të gjitha ato kanë me kalu sepse e kanë një kontratë dhe një listë që është zyrtare me protokoll dhe ajo nuk anulohet por tash na duhet një kohë pak më shumë. Drejtoresha tutje jep sqarime dhe thotë që do ti sjell dy listat.

Remzi Bajselmani - shqetësimi është me vend për konkursin. Ne si DKA kemi zhvillu deri në 10 konkurse në vit dhe kemi kryer punë siq duhet por tani kohëve të fundit ka ndryshu forma e konkursit dhe është bart te Zyra e Burimeve Njerëzore në komunë gjë që na ka shkaktu shumë telashe sepse edhe ata nuk kanë qenë mjaft të përgaditur, nuk kanë pas njerëz dhe është vonu por me përgjegjësi të plotë të them

që vetëm në shkollën “7 Marsi” nuk janë mbajten orët e TIK-ut dhe në të gjitha shkollat tjera mbahet mësimi. Te shqetësimi i shkollës në Bllacë e kemi sqaru dhe do të zgjidhet shumë shpejt.

Urim Suka - për mua dhe besoj edhe për secilën shkollë nuk ka fare rëndësi të kush bie përgjegjësia sa ka rëndësi vonesa që po ndodh. Ajo zyre mund ta argumentoj dhe do të interesohem nëse kërkesa e drejtorit ka shku me kohë. Është mirë me pas parasysh që kërkesa me shku me kohë. Nuk po e kërkoj fajtorin por mua më intereson që ky proces është vonu dhe dëmi është nëpër shkolla.

Remzi Bajselmani - propozimet edhe emrat dhe vendet kanë shku me kohë në qershor. Është formë e re në tërë Kosovës dhe problem është në gjithë Kosovën forma e rekrutimit në sistemin arsimor. Sa i përket humbjes së orëve drejtori është kujdes dhe orët nuk humbin.

Qëndrim Elshani - ne si qenie njerëzore dallojmë prej qenieve tjera për shkak se nuk do të ishim të tillë nëse nuk i kishim dal hak atëdheut, familjes dhe pronës. Si i tillë unë i uroj shërim të plotë dhe të shpejt krejt të sëmurëve me cilën do sëmundje që e kanë. Unë po lidhem me shkrimin tim në rrjetin social facebook ku kam bërë një pyetje të thjeshtë dhe nuk i jam drejtu asnjë personi me emër të veçantë mirëpo iu kam drejtu një partie politike që tek e fundit nuk është që nuk e kanë praktiku atë gjë në të kaluarën. Albani nuk është këtu mirëpo unë do të sqarohem sepse unë nuk kam dasht me lëndu askënd. Sa i përket pyetjes, e kam një kërkesë nga operatorët e telekomit dhe operatorët tjerë, që në rrugën “Skënderbeu” është një trasë ekzistuese por është edhe një trasë e re që u ndërtu së fundi. Puseta fundore në dy skajet e trasës së re duhet m’u lidhë në pusetat më të afërta të trasës ekzistuese ose duhet me i kriju dy puseta në trasën ekzistuese pa e dëmtu infrastrukturën në trasën ekzistuese. Kjo do të shërbente që të ruhen kabllat në trasën e vjetër ku deri tash nuk janë dëmtu dhe do ta mundësonte qasjen më të lehtë të gjithë operatorëve telefonik apo operatorëve të ndryshëm në këtë rrugë. Unë nuk jam ekspert i çështjes por mundeni me dal me ekspert të fushës dhe unë po e ngris shqetësimin e tyre.

Enver Shabani - unë ju këshilloj juve dhe ata të tjerët ta bëjnë një kërkesë me shkrim në njesinë e kërkesës pasi njesia e kërkesës është DSHPE dhe në kërkesën e atyre e adresojmë me automatizëm te menaxheri i cili e udhëheq projektin. Rruga “Skënderbeu” ka një projekt detal dhe pa ndërhyrje të projektanit nuk guxojmë me bo ndonjë ndryshim.

Qëndrim Elshani - sipas eksperteve kostoja e vetme shtesë është hapja e dy pusetave ose hapja e kanalit deri te puseta më e afërt në trasën ekzistuese.

Liridon Fandaj - po e shoh që pozita ka qenë vetëm për me votu buxhetin dhe janë shumë pak dhe nuk di a kemi kuorum të mjaftueshëm. Pyetje për Drejtorinë e Kulturës. Është një lapidar tek varrezat që përfundon rruga “Skënderbeu” dhe është i dëshmorit Nystret Gashi. Tani aty janë duke u zhvillu punime dhe cilat janë masat që kanë marrë si drejtori për mbrojtjen e atij lapidari. Unë e kam marrë një shqetësim edhe nga djali i dëshmorit që Kryetari e ka kontaktin në telefon dhe i ka thënë: ku me qu këtë lapidar. Kjo është shqetësuese dhe është marre që atë lapidar mos ta mirëmbajnë dhe mos ta ruajnë.

Kryesuesi - nuk i ka thënë ashtu si the ti sepse unë kam qenë prezent por me zhvendos pak po.

Liridon Fndaj - kisha kurku prej Drejtoreshës së Kulturës ose cili është kompetent se cilat janë masat për me mbrojt atë lapidar?

Lorika Gashi - muajin e fundit të gjithë lapidarët nuk janë kompetencë e komunës aspak. Ka ardhë vendimi prej ministrisë që kompetenca ka me i kalu ministrisë por kjo nuk e shfaqson atë. Problemi te lapidar i dëshmorit Gashi, e di që janë marrë gjatë Kryetari bashkë me drejtorat dhe menaxherin e projektit të rrugës “Skënderbeu” ka bisedu me familjarët por nuk jam në rrjedha nga që nuk kam qenë në takime. Asnjë dëshmor dhe asnjë lapidar nuk shembet ose nuk largohet prej vendit. Secili e ka vendin e vet dhe historia nuk e fshin edhe nëse dojmë dhe besoj shumë shpejt ka me u gjet zgjidhja.

Dardan Berisha - kam dy shqetësime që vijnë prej qytetarëve e cila ka të bëjë me DKA-në. E para ka të bëjë me mungesën e asistentëve për fëmijë me nevoja të veqanta. Janë 5 nxënës që kanë nevojë për këta asistentë në shkollën e ulët “7 Marsi”. Urgjentisht me kërkesën e prindërve dhe të psikologut së bashku me drejtorin e Arsimit me gjet zgjidhje për këta prindër. Është një shqetësim tjetër i disa grupeve ose rrebelëve që janë duke u kriju në atë shkollë. Ka shumë fëmijë që të premtën e kaluar nuk kanë guxu me shku në shkollë. Lus drejtorin që ta merr si sugjerim ose këshill që sëbashku me organet kompetente të policisë, me shku dhe me i verifiku në shollën “7 Marsi”. Është një lloj përgjegjësie e drejtorit edhe mos planifikimi i mirë i buxhetit që neve sot na len pa paga si asambleist dhe si KPF. Ju ka bërë dëm edhe

drejtorave,kolegëve të vet sepse të gjitha subvencionet ia ka marrë përmbaruesi.Unë nuk e di,një drejtor i Arsimit i cili ka një milion gabime edhe vazhdon me nejt Drejtor i Arsimit pa asnjë përgjegjësi.Shqetësimet e qytetarëve është mirë të merren parasysh.

Remzi Bajselmani - sa i përket pyetjes së parë shqetësimi është me vend,e kemi këtë shqetësim ne si DKA.Në komunën e Suharekës funksionon një ekip për vlerësim pedagogjik i cili merret me këtë çështje.15 asistent i kemi në shkollat e komunës së Suharekës.Kërkesat janë të mëdhaja edhe në Peqan,Sallagrazhde dhe në disa shkolla tjera por numri i të punësuarve është sipas kodit buxhetor që vjen prej Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Financave. Jemi duke bërë përpjekje për me iu dal ballë këtyre kërkesave por me keqardhje e them që numri i fëmijëve me nevoja të veqanta është rrit kohëve të fundit dhe ka kërkesa të shumta.Kemi asistent në shkollën “7 Marsi”,është psikologja,është ekipa e cila merret me atë çështje.Edhe për këtë kemi bërë kërkesë në Ministrinë e Arsimit për me na leju me i marrë sëpaku 4 asistente dhe njëri prej tyre do të shkoj në shkollën “7 Marsi”.Për pyetjen e dytë nuk kam informacion sepse askush nuk e ka ngrit deri më sot.Dje kemi pas takim me strukturat e policisë,drejtorinë rajonale,drejtorat e shkollave,këshillat drejtues të shkollave.Tema ka qenë siguria nëpër shkolla dhe janë debatu të gjitha çështjet lidhur me sigurinë.Ka qenë drejtori i shkollës “7 Marsi” dhe kryetari i bordit të shkollës por nuk e kanë ngrit si shqetësim këtë çështje.Do ta kontaktoj drejtorin dhe do të shkoj në shkollë se për çka bëhet fjalë. Ne i kemi organet kompetente që do të reagojnë për këtë.Për pjesën e fundit e teprove sepse 0 kompetencë nuk e ka DKA-ja lidhur me kontratën kolektiv dhe e kemi sqaru disa herë.Të gjitha komunat janë kolaps dhe disa komunave ia kanë heq edhe kodin buxhetor sepse është çështje e qendrës dhe nuk është çështje lokale.Asnjë komunë nuk ka bërë zgjidhje ndryshe që me marrë edhe ne.

Dardan Berisha - më tregoj drejtori që keni qenë në takim dhe e keni diskutu çështjejn e sigurisë por besoj që mjafton edhe unë që po e ngris këtë shqetësim sepse jam i zgjedhur i qytetarëve.Sa i përket asaj keni mujt me i ekzekutu mjetet dhe mos me ardhë në këtë gjendje.Më mirë është me i ekzekutu ato mjete se me i marr përmbaruesi 2 milion.Sa i përket modelit,unë të sugjeroj të shkosh te Fadil Nura në Skenderaj dhe e merr modelin.

Festë Kabashi - sa i përket shkollës “7 Marsi” dhe me që jam mësimdhënëse aty, i jap vetes të drejtë me u inkuadru në këtë debat.Këto shqetësime qëndrojnë 100%.Edhe unë dashta me marrë fjalën pa reagu Dardni por mirë që është edhe një zë i dytë për këto shqetësime.Ju drejtor e keni postu veq se në facebook takimin me drejtorët e shkollave pikërisht për çështjen e sigurisë dhe më erdhë shumë mirë pa ditë që drejtori i shkollës nuk i ka ngrit këto shqetësime që ekzistojnë.Unë si pjesë e stafit çdo ditë aty i shoh,jam në rrejdha ,jam kujdestare e klasës,jam në kontakt me prindërit dhe nxënësat.Siguria mungon në atë shkollë edhe brenda objektit por sidomos brenda oborrit të shkollës.Ndoshta do të ishte mirë me kriju një ide të thjeshtë që nxënësat e shkollave të tjera të paktën gjatë orarit mësimor mos e u leju me hy brenda përbrenda objektit ose në oborr të shkollës.Aty ka qasje gjithëkush,ka nxënës të shkollave të mesme sidomos të shkollës teknike,ka nxënës të shkollave fillore të fshatrave që vijnë pasdite.Rrehen mes vete,kacafyten,ka video inqizime që ekzistojnë për këto gjëra te nxënësat,te prindërit.Mua gjithmonë më pengon edhe prej anës së nxënësave,prej anës së prindërve,prej anës së stafit mësimor e drejtorit e ndoshta tani vjen deri tek ju në fund,që tendenca është me i minimizu problemet.Kur je pjesë e asaj shkolle ndihesh keq por ndihesh keq kur je pjesë edhe e kuvendit komunal dhe nuk je duke bërë asgjë për këtë punë.Të gjithë jemi pjesë e kësaj dhe të gjithë duhet me i thirr ndërgjegjës dhe bëj apel,po i bashkangjitem Dardanit për me kriju një zgjidhje për pjesën e sigurisë.

Bulëza Kuçi - pa dasht me shfajsu Drejtorin e Arsimit,dua ta pyes Festën: këta si staf i shkollës çka kanë bërë?Unë e di që çdo ditë ka kujdestar dite aty dhe kujdestarët e ditës nuk kanë drejtë me nejt vetëm brenda objektit të shkollës por ata duhet me dal edhe në oborr të shkollës dhe përveq kësaj janë edhe stafi teknik. A është aq e rëndë gjendja që mos me mujt mësimdhënësi dhe stafi teknik me qetësu këtë shtet dhe me kalu te naj truproje ose naj sigurim të policisë ?sepse nëse është aq e rëndë gjendja,po qohemi krejt dhe po e bëjmë një zgjidhje. Aty janë dikun rreth 40 mësimdhënës që nëse është me ditë ose javë kjo çështje delikate,atëherë duhet m'u qu krejt mësimdhënës në këmbë.Unë nuk kam dëgju por po flas për shkollën time ku nuk guxon me ndodh një çështje aty për deri sa ne jemi aty.Një herë është dasht me zgjidh ju përbrenda aty e tani me kalu pjesë tjera.

Kryesuesi - ne nuk do ta gjuajmë fajin te njëri tjetrin. Ne e dime që shkolla “7 Marsi” është afër stadiumit të qytetit dhe dime që në stadium të qytetit çdo orë pothuaj ka lëvizje të grupmohave të ndryshme që shkojnë dhe ushtrojnë aty deri në 7 të mbrëmjes dhe njëra prej problemeve është ajo.

Bulëza Kuçi - nëse është çështja aq delikate atëherë kemi shembuj të ndryshëm në Prizren kur mblihet këshilli i prindërve dhe me forcat e veta e paguajnë një sigurim dhe zgjidhet situata.

Dardan Berisha - kur është keqmenaxhimi prej së larti, kjo shkon zingjir. Drejtori i Arsimit është për teren dhe jo me nejt në zyre. Kur ta ngrit shqetësimin një asambleist duhet ta merr më seriozisht dhe mos ta merr çdo herë kritikë. Ne po falsim sa nuk kanë ndodh problemet. Problemet ndodhin në rrugë, në lokale dhe ne e dime që ndodhin probleme por ne duhet ta trajtojmë që mos me ardhë te një problem më i madh. Esenca është që me pas parasyh që me u sjell policia ngapak dhe pajtohem me ty nëse ka ndonjë kujdestari dhe këshilli i prindërve.

Festë Kabashi - dua të kthehem mbrapa te një projekt që ka qenë prej opozitës, saktësisht prej Urim Sukës kur ka dhënë ide për me u kriju disa komisione kontrolluese për arsim, shëndetësi dhe punime në rrugë. Unë jam paragjyku për atë përkrahje që e kam dhënë për shkakun se është mendu që është tendencioze prej anës time që po du me ju kundërvy partisë që i përkas. Qëllimi im ka qenë pikërisht këtu. Unë nuk po e fajsoj aspak drejtorin sepse drejtori ka shumë obligime dhe çdo ditë me dal te secila shkollë prap nuk i mjafton koha dhe e kam parasysh. Për këtë arsye nëse do të ishte shtu niveli i kontrollit të disa komisioneve me qëllim pozitiv, me pas kontroll më shumë, llogaridhënie, përgjegjësi, rrjedhimisht në fund edhe performacë më të mirë. Kjo ka qenë qëllimi pse mua m’u ka dok e arsyeshme kur ka ardhë dy herë ky propozim dhe nuk ka kalu. Pyetjet e Bulëzës janë të arsyeshme. Sa i përket shkollës tonë, kujdestarët e ditës e ushtrojnë detyrën brenda objektit të shkollës deri tek dera jasht kur të hyjnë rreshtat brenda. Mund ta kesh parasysh sa hapësirë të madhe ka shkolla dhe oborri ku mund të ndodh çka do dhe ne mos me e vërejt. Ka nevojë me u ul dikush me diskutu për këtë gjë dhe me ardhë te një zgjidhje edhe më e mirë se që unë po propozoj por thjesht kjo është një ide e momentit që të paktën gjatë orarit mësimor sa është cilikli i lartë dhe i ulët në mësim, mos të lejohen nxënës të shkollave të mesme, individ të huaj me u fut brenda objektit ose oborrit shkollor.

Kryesuesi - kjo i takon KKS-së dhe e diskutojnë edhe aty ku janë edhe policia.

Festë Kabashi - i takon por në momentin kur nuk shpërfaqen këto shqetësime, askush s’ka çka bën sepse ato duhet të shpërfaqen.

Aziz Bytyqi - pozita e shkollës ku është ka qasje prej gjeneratave të ndryshme por si zgjidhje për të ardhmen, ajo hapësirë shkollore duhet të mbyllet dhe qasja të jetë vetëm për nxënës dhe mësime.

Takimi përfundoi: 12:50

Procesmbajtësja: Dafina Haziraj